

STATUTI I SHOQËRISË ADRIJON72 SH.P.K.

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar SH.P.K. **ADRIJON72** është krijuar sot me datë 25.06.2024 sipas Statutit të përpiluar dhe nënshkruar nga ortakët, Zoti Mehmet Gürsoy, i biri i Ilhami, i datëlindjes 13.02.1975 shtetas turk, rezident në rrugën Migjeni, Banesa nr.16, Zona Kadastrale nr,8320, numri i pasurisë 1497, Tiranë, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, i identifikuar me pasaportë biometrike me numër U23012117, në cilësinë e "Ortakut themelues të shoqërisë ADRIJON72" SH.P.K., me vullnet të lirë, të plotë e të sinqertë, dhe iniciativën e lirë private, mbështetur në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe Kodin Civil në fuqi, në ligjin nr.9901, datë 14.04.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", ligjin nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Bisnesit ", në atë Doganor, Fiskal e Tatimor, themelojmë shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar me emërtimin ADRIJON72 SH.P.K. (më poshtë e quajtur "Shoqëria")

KREU I

Neni 1

Krijimi

Shoqëria ADRIJON72 SH.P.K., është person juridik i të drejtës shqiptare, Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (më poshtë e quajtur "Shoqëria").

Neni 2

Personaliteti i juridik

Shoqëria fiton personalitetin juridik me regjistrimin në QKB.

Kontributi i ortakëve përbën kapitalin e regjistruar të shoqërisë.

Ortakët gëzojnë secili kuotën e vet në shoqëri, në përpjestim me kontributin që kanë dhënë në kapital.

Neni 3

Selia

Shoqëria e ka selinë në: në rrugën Migjeni, Banesa nr.16, Zona Kadastrale nr,8320, numri i pasurisë 1497, Tiranë.

Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj, të hapë zyra përfaqësie, degë, të krijojë filiale, si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë, vetëm me vendim të asamblesë së përgjithshme.

Neni 4

Objekti i veprimtarisë

Zhvillimi i studimeve të fizibilitetit për objektet e trajtimit të ujit të pijshëm në të gjitha llojet e institucioneve publike dhe private, organizatave dhe administratave financiare, të ngrihen të gjitha llojet e impianteve të trajtimit të mbetjeve ujore, të trajtimit të ujërave të ndotura dhe të përpunimit të mbetjeve të ngurta, duke përfshirë blerjen, shitjen dhe furnizimin e çdo lloj materiali për to, si dhe për të kryer punime ndërtimi në lidhje me to. Të ofrojë shërbime mirëmbajtje dhe konsulence në lidhje me montimin dhe vënien në punë, si dhe të kryejë mirëmbajtjen dhe riparimin e këtyre punimeve.

Të prodhojë, të blejë dhe të shesë, të importojë dhe eksportojë të gjitha llojet e makinerive, aparaturave, agregateve dhe kallëpeve të tyre dhe pjesëve të ndryshme që lidhen me fushën.

Të kryejë të gjitha llojet e punime të ndërtimit, riparime dhe punimet me kontraktim në të gjitha institucionet dhe organizatat publike e private dhe të administratave vendore; të ketë pjesëmarrje në tendera që lidhen me sektorin e ndërtimit dhe kontraktimit, ngritjen e qendrave masive të banimit dhe biznesit; të kryejë blerje të tokës, pronës, objekteve dhe ndërtesave për ndërtim, sipërmarrje me kontraktim, dhënie dhe marrje me qira, kryerjen e punëve ndërtimore në këmbim të banesave dhe kateve, të kryejë punime ndërtimore për ndërtimin e kantierëve, fabrikave, rezervateve, digave, kanaleve vaditëse, kanalizimeve, porteve, rrugëve, aeroporteve, hekurudhave, urave, kanaleve, barrierave dhe të gjitha llojeve të objekteve sociale, të gjitha llojet e punimeve të gërmimeve në tokë dhe mbushje me dhe, punime të dekupazhit dhe peizazhit dhe të gjitha punimet në sferën e ndërtimit si brenda ashtu edhe jashtë vendit. Të ofrojë shërbime të arkitekturës, inxhinierisë, konsulencës, planifikimit, projektit dhe mbikëqyrjes brenda dhe jashtë vendit.

Blerje, shitje, import dhe eksport të të gjitha llojeve të materialeve dhe produkteve të ndërtimit, materialeve elektrike, bojërave të brendshme dhe të jashtme, materialeve dekorative; mobileri, dyer dhe dritare me material druri, plastike pvc, alumini, hekuri dhe materiale të ngjashme metalike, si dhe të gjitha llojet e mallrave që janë të nevojshme në fushën dhe industrinë e ndërtimit.

Të kryejë dhe të delegojë të gjitha llojet e punimeve inxhinierike që lidhen me subjektin dhe objektin e firmës, si brenda dhe jashtë vendit.

Për t'u përfshirë në aktivitetet e shkruara më sipër, shoqëria mund të kryejë transaksionet dhe aktivitetet e mëposhtme, me kusht që ato të lidhen me subjektin e saj.

Të kryejë investime strategjike industriale dhe tregtare në kuadër të veprimtarisë së shoqërisë, të krijojë depo dhe magazina private, dyqane për shitje, zyra dhe fabrika. Të punësojë punëtorë të të gjitha kualifikimeve brenda dhe jashtë vendit dhe t'i transferojë ata pa heqje dorë nga e drejta. Marrje dhe dhënie me qira dhe përdorimi i veglave, makinerive dhe pajisjeve të ndryshme të punës. Hapjen ekspozitave të përhershme dhe të përkohshme për ekspozimin e mallrave me qëllim shitje, mirëmbajtje dhe ngritje pika kontakti tregtare.

Të ndërmarrë angazhime të ndërsjellta dhe reciproke me persona zyrtarë, privatë dhe juridikë për çështje që lidhen me subjektin dhe aktivitetin e shoqërisë, si dhe pjesëmarrje në tendera. Për të arritur qëllimin e saj, kompania mund të blejë, shesë, marrë ose japë me qira të gjitha llojet e pasurive të paluajtshme, të vendosë të gjitha llojet e të drejtave reale dhe personale mbi to; të marrë, japë dhe lirojë hipoteka. Shoqëria mund të vendosë servitutin, uzufuktin, detyrimin e pasurisë së paluajtshme, servitutin e dyshemesë dhe pronësinë e katit mbi pasurinë e saj të paluajtshme. Për të gjitha llojet e pasurive të paluajtshme, shoqëria mund të kryejë të gjitha llojet e procedurave dhe transaksioneve për aneksimin, ndryshimin, tjetërsimin, veçimin, bashkimin, ndarjen dhe nëndarjen e pronës dhe pasurisë pranë zyrave të kadastrës.

Neni 5

Kohëzgjatja

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohore të papërcaktuar.

KREU II

KAPITALI

Neni 6

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100.000 lekë, me vlerë nominale 100.000 lekë. Kuotat e kapitalit themeltar zotërohen 100 % të kapitalit me 1 (një) kuotë nga ortaku Mehmet Gürsoy me 1 kuotë me 100 % = (100.000 lekë).

Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregtueshme. Kontributi i ortakut mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta).

Ortaku përgjigjet për humbjet e shoqërisë përkundrejt të tretëve deri në vlerën e kontributit të tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Neni 7

Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme duke kontribuar në para ose me anë të kontributeve në natyrë, dhe në shërbime, si dhe nga fitimet e shoqërisë.

Zvogëlimi i kapitalit themeltar në një vlerë më të vogël se ajo e përcaktuar në nenin 6 të këtij statuti, e bën të detyrueshme marrjen e një vendimi prej shoqërisë për zmadhimin e kapitalit themeltar të paktën deri në vlerën minimale.

Në rast të moszbatimit të kërkesave të këtij paragrafi, çdo person i interesuar mund të kërkojë në rrugë gjyqësore prishjen e shoqërisë. Kjo prishje nuk mund të shpallet, në qoftë se rregullimi është bërë në ditën kur gjykata mbledhet për të marrë vendim.

Neni 8

Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- shitblerjes;
- trashëgimisë;
- dhurimit;
- çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit të saj në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, sipas nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit". Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

KREU III

ORGANET VENDIMMARRËSE DHE DREJTUESE

Neni 9

Organi Vendimmarrës

Asambleja e Përgjithshme është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

Çdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKR për të pasyqruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.

Asambleja e Përgjithshme, vendos për çështje si:

- përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- emërimin dhe shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të regjistruar;
- përcaktimin e shpërblimeve
- mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

Të gjitha vendimet e marra nga asambleja e përgjithshme regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Duhet regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:

- miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- investime;
- vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- thirrjen e mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme.

Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmerinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmerinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

Neni 10

Administrimi

Administrator i shoqërisë është Z.Asim Bruçi, emëruar në këtë detyrë për një afat 5 vjeçar me të drejtë ripërtëritje, me letërnjoftim elektronik nr.037840296 dhe numër personal H20605141V.

Administratori emërohet dhe shkarkohet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

Neni 11

Kompetencat

Administratori ka të drejtë dhe detyrohet të:

- kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- përfaqësojë shoqërinë tregtare;
- kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- përgatisë dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, ti paraqesë këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- kryejë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- raportojë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

Administratori është i detyruar të thërrasë mbledhjen e asamblesë së përgjithshme edhe në rastet kur:

sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim dhe kur shoqëria brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të çertifikuara.

Administratori ka të drejtë të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm e të jashtëzakonshëm.

Administratori përfaqëson Shoqërinë përpara të gjitha personave fizikë e juridikë, publikë dhe/ose privatë vendas apo të huaj, autoriteteve shtetërore Shqiptare apo të huaja, përfshi këtu autoritetet gjyqësore të të gjitha shkallëve.

Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rrethanat me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep shprehimisht ortakëve të shoqërisë.

Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.

Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i administratorit e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rrethanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

Neni 12

Përgjegjësitë

Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga Asambleja e Përgjithshme që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", administratori detyrohet:

- të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;
- të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
- të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
- të parandalojë dhe mënjanë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;
- të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjet ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", kryen veprimet e mëposhtme:

- u kthen ortakëve kontributet;
- u paguan ortakëve interesa apo dividendë;
- u shpërndan aktivet shoqërisë;
- lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
- jep kredi.

Neni 13

Viti Financiar

Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor, me përjashtim të vitit të parë financiar që fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Neni 14

Bilanci i shoqërisë dhe dividendët

Brenda 6 muajsh nga mbyllja e vitit financiar, Mbledhja e Asamblesë së Përgjithsme, miraton bilancin e paraqitur nga Administratori.

Mbledhja e Ortakëve të shoqërisë vendos rreth shpërndarjes së dividendit, pasi të jenë zbritur humbjet e vitit të mëparshëm financiar, siç edhe parashikohet nga ligji.

Neni 15

Ekspertet

Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarisë ekonomiko-tregtare të shoqërisë, atë gjithë vjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë i ngarkuar nga ana e asamblesë së përgjithshme.

Në përfundim të kontrollit eksperti kontabël i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe për atë për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar që t'ja paraqesë dhe dorëzojë në kohë asamblesë së përgjithshme për t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që ka.

Neni 16

Të ardhurat neto (Dividenti) që mbeten pas veçimit të fondeve ligjore të mësipërme dhe të atyre për shlyerjen e çdo detyrimi fiskal apo likuidimin e pagesave ndaj të tretëve, i mbeten dhe i kalojnë në pronësi Asamblesë së shoqërisë, të cilat mund të kalojnë dhe për zmadhimin e kapitalit.

Neni 17

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë.

- kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar ne themelimin e saj;
- me vendim të ortakut të vetëm;
- me hapjen e procedurave të falimentimit;

- nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit",
- me vendim të gjykatës;

Në këtë rast Asambleja e Përgjithshme merr vendim me shkrim në të cilin parashikon mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar një apo disa likuidatorë dhe shënuar në çdo dokument të nxjerrë prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtesë "Shoqëri në likuidim e sipër".

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likujduesit e emëruar nga Asambleja e Përgjithshme.

Nëse Asambleja e Përgjithshme nuk merr një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 diteve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likujdues.

Neni 18

Likujduesi merr përsipër të drejtat dhe detyrimet e administratorëve nga data e emërimit të tij. Nëse shoqëria emëron më shumë se një likuidues, përveç se kur akti i emërimit parashikon se ata veprojnë veçmas njëri-tjetrit, likuiduesit ushtrojnë bashkërisht të drejtat e detyrimet sipas këtij ligji. Likujduesit mund të autorizojnë njërin prej tyre të kryejë veprime të një kategorie të posaçme.

Kufizimet e tagrave të likuiduesve u kundrejtohen të tretëve, në përputhje me përcaktimet e ligjit. Likujduesi u nënshtrohet mbikëqyrjes së ortakëve dhe administratorit.

Neni 19

Të drejtat e detyrimet e likuiduesit

- Detyra e likujduesve është mbyllja e të gjitha veprimeve të shoqërisë, mbledhja e kredive të paarkëtuara dhe e kontributeve të pashlyera, shitja e pasurive të shoqërisë dhe shlyerja e kreditorëve duke respektuar radhën e referimit, sipas nenit 605 të Kodit Civil.

- Likujduesi mund të kryejë edhe veprime të reja tregtare, për mbylljen e një veprimi të papërfunduar.

- Nëse, në bazë të padive të ngritura nga kreditorët, sipas nenit 194 të ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", likuiduesit vërejnë se pasuria e shoqërisë tregtare, përfshirë kontributet e pashlyera, nuk është e mjaftueshme për pagesën e këtyre pretendimeve, likuiduesit detyrohen ta pezullojnë procedurën e likuidimit e t'i kërkojnë gjykatës përkatëse nisjen e procedurave të falimentimit.

Likujduesi përgatit një bilanc të gjendjes së shoqërisë në castin e hapjes së likuidimit dhe një bilanc përfundimtar në çastin e mbylljes së këtyre procedurave. Nëse procedura e likuidimit zgjat më shumë se një vit, likuiduesi përgatit, gjithashtu, pasqyrat financiare vjetore të shoqërisë. Bilancet në shoqërinë kolektive dhe komandite miratohen nga ortakët e tjerë, ndërsa në shoqëritë aksionare apo nga ato me përgjegjësi të kufizuar miratohen nga asambleja e përgjithshme.

Neni 20

Përfundimi i likuidimit

Pas shpërndarjes së aktiveve të mbetura, likuiduesi e njofton Qendrën Kombëtare të Regjistrimit për përfundimin e likuidimit dhe kërkon çregjistrimin e shoqërisë, në përputhje me seksionin V, të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit".

Neni 21

Bashkimi

Dy ose më shumë shoqëri mund të bashkohen nëpërmjet:

- Kalimit të të gjitha aktiveve e pasiveve të njëres ose më shumë prej shoqërive, që quhen shoqëritë e përthithura, të një shoqëri tjetër ekzistuese, e quajtur shoqëria përthithëse, në këmbim të aksioneve apo kuotave të kësaj shoqërie. Ky proces quhet bashkim me përthithje.
- Themelimit të një shoqërie të re, tek e cila kalohen të gjitha aktivet e pasivet e shoqërive ekzistuese, që bashkohen në këmbim të aksioneve apo kuotave të shoqërisë së re. Ky proces quhet bashkim me krijim i një shoqërie të re.

Neni 22

Ndarja

Një shoqëri mund të ndahet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme, duke transferuar të gjitha aktivet e pasivet e veta në favor të dy ose me shumë shoqërive ekzistuese apo të themeluara rishtazi. Shoqëria që ndahet, vlerësohet e prishur.

Për ndarjen e shoqërisë zbatohen përkatësisht dispozitat e neneve 216 deri në 225 të ligjit nr.9901, datë 14.04.2008.

Shoqëritë, që fitojnë pasuritë e shoqërisë që ndahet, quhen shoqëri pritëse dhe përgjigjen në mënyrë solidare për detyrimet e kësaj të fundit.

Regjistrimi i ndarjes së shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit ka si pasojë kalimin të shoqëritë pritëse të të gjitha aktiveve e pasiveve të shoqërisë që ndahet, në përputhje me raportin e ndarjes, të përcaktuar në marrëveshjen e ndarjes,

Ky kalim sjell pasoja për marrëdhëniet ndërmjet shoqërive, si dhe për palët e treta; bërjen e aksionarëve/ortakëve të shoqërisë që ndahet aksionarë apo ortakë të një ose më shumë shoqërive pritëse, në përputhje me raportin e ndarjes, përcaktuar në marrëveshjen e ndarjes; vlerësimin e shoqërisë që ndahet si e prishur dhe çregjistrimin e saj nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit, sipas seksionit V të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" pa kryerjen e likuidimit.

Neni 23

Shndërrimi

Shoqëria mund ta ndryshojë formën e vet ligjore, nëpërmjet shndërrimit të saj në shoqëri aksionare.

Shndërrimi nuk sjell pasoja mbi të drejtat e detyrimit, që shoqëria ka marrë përsipër ndaj të tretëve.

Neni 24

Baza Ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 25

Mosmarrëveshjet

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tretëve, do të jetë kompetente Gjykata Shqiptare.

Neni 26

Dispozita përfundimtare

Ky Statut u redaktua në 4 kopje me vlera të njëjta juridike në gjuhën shqipe, dhe pasi iu lexua ortakëve themeltar të shoqërisë, nënshkruhet me vullnetin e tyre të lirë nga ortakët themelues.

ORTAKU THEMELUES MEHMET GÛRSOY

